

## INTEREST IN ISLAM AND OTHER RELIGIONS

**Abdulxhemil Nesimi**

Faculty of Islamic Sciences-Skopje, Republic of North Macedonia, [Abdulxhemil\\_nesimi@hotmail.com](mailto:Abdulxhemil_nesimi@hotmail.com)

**Abstract:** The concept of interest has a very ancient history, its peculiarity is that the first writings prove that it was considered hated and evil in all religions. Interest was forbidden and unacceptable in the Jewish religion, as well as in the Christian one. But the Jews, after the Prophet Moisi allowed the taking of interest by the non-Jews for them, claiming that the wealth of the non-Jews is permissible, according to their belief the Jewish people are the chosen people, therefore they have priority and value over all other peoples. So other people, who are non-Jews, they treat as inferior, worthless and have the right to manipulate them as they please. Allah, the Exalted in the Qur'an, conveys their claim: "They (Ahl al-Kitab, the followers of the Book) used to say: 'We have no responsibility for (the wealth we take) from the ignorant (others).'" (Quran, 03 : 75)

The treatment of interest as a bad thing is also followed by many ancient philosophers. It is established that the eminent Roman theorist and orator Marcus Tullius Cicero had banned usury in his writings. Even the ancient Greek philosophers, such as Plato in "The Republic" and Aristotle in "Politics", forbade usury.

Despite the belief in the hearts of people in general that interest work is not pure, yet all the systems known to people today have not survived the contemporary momentum that violates all norms and foundations of humanity and free conscience. Christians, although they clearly know that this is a sin in their religion, failed to withstand the storm of numerous interest-bearing transactions, so they surrendered and, instead of opposing it, gave way to permitting. of interest. On the other hand, Islam is the only system that has remained in this battle and continues to fight this habit, even though it has become the daily routine of many people.

We have mentioned above the attitudes of the earlier laws and systems for taking interest in order for the reader to understand that the prohibition of interest is not specific to Islamic jurisprudence, as he can understand it now in modern times, as only Muslims speak of its haram.

**Keywords:** religion, interest, social, economy, politics.

## KAMATA NË ISLAM DHE NË RELIGJIONET TJERA

**Abdulxhemil Nesimi**

Fakulteti i Shekecave Islame-Shkup, Maqedonia e Veriut, [Abdulxhemil\\_nesimi@hotmail.com](mailto:Abdulxhemil_nesimi@hotmail.com)

**Abstrakt:** Koncepti i interesit ka një histori shumë të lashtë, e veçanta e tij është se shkrimet e para vërtetojnë se ai konsiderohej i urryer dhe i keq në të gjitha fetë. Interesi ishte i ndaluar dhe i papranueshëm në fenë hebraike, si dhe në atë të krishterë. Por çifutët, pasi Profeti Moisi lejoi marrjen e interesit nga johebrenjtë për ta, duke pretenduar se pasuria e johebrenjve është e lejuar, sipas besimit të tyre populli hebre është populli i zgjedhur, prandaj ata kanë përparësi dhe vlerë mbi të gjithë popujt e tjerë. Pra, njerëzit e tjerë, të cilët janë johebrenj, i trajtojnë si inferiorë, të pavlerë dhe kanë të drejtë t'i manipulojnë si të duan. Allahu i Lartësuar në Kur'an e përcjell pretendimin e tyre: "Ata (Ehli Kitab, ithtarët e librit) thoshin: Ne nuk kemi përgjegjësi për (pasurinë që marrim) nga injorantët (të tjerët)." (Kur'an, 03:75)

Trajtimi i kamatës si një gjë e keqe ndiqet edhe nga shumë filozofë të lashtë. Është vërtetuar se teoricieni dhe oratori i shquar romak Marcus Tullius Cicero e kishte ndaluar kamatën në shkrimet e tij. Edhe filozofët e lashtë grekë, si Platoni në Republikën dhe Aristoteli në Politikë, e ndaluan fajden.

Pavarësisht besimit në zemrat e njerëzve në përgjithësi puna me interes nuk është e pastër, megjithatë, të gjitha sistemet e njohura për njerëzit sot nuk i kanë mbijetuar vrullit bashkëkohor që shkel të gjitha normat dhe themelet e njerëzimit dhe ndërgjegjes së lirë. Të krishterët, ndonëse e dinë qartë se ky është një mëkat, nuk arritën t'i bënin ballë stuhisë së transaksioneve të shumta me kamatë, ndaj u dorëzuan dhe në vend që ta kundërshtonin, ia dhanë vendin lejimit me interes. Nga ana tjetër, Islami është i vetmi sistem që ka mbetur në këtë betejë dhe vazhdon ta luftojë këtë ves, edhe pse është bërë përditshmëri e shumë njerëzve.

Më lart kemi përmendur qëndrimet e ligjeve dhe sistemeve të mëparshme për interesimin, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se ndalimi i kamatës nuk është specifik për jurisprudencën islame, pasi ai mund ta kuptojë tani në kohët moderne, pasi vetëm myslimanët flasin për të.

**Fjalë kyçe:** religion, interes, social, ekonomi, politik.

## 1. PËRKUFIZIMI I KAMATËS NË ISLAM

Në gjuhën arabe kamatës i thonë “*riba*”. Ky emërtim rrjedh nga folja “*reba, jerbu*”, që do të thotë “*shtim, teprim dhe rritje*”. Trajtimet e fukahave rreth përkufizimit të kamatës në aspektin terminologjik janë të shumta, disa janë më gjithëpërfshirëse dhe disa të tjera më pak. Për të mos e rënduar këtë shkrim duke përmendur përkufizime të shumta, do të sjellim vetëm përkufizimin e juristëve hanefi, i cili është më i qartë dhe më i kuptueshëm. Ata thonë: “Kamatë është ajo sasi e pasurisë e cila kushtëzohet të shtohet pa kompensim gjatë transaksioneve (këmbimeve) të ndërsjella të pasurisë me pasuri.”

Në kohën bashkëkohore, krahas termit “kamatë” përdoren edhe disa emërtime të tjera, sikurse “*fajde*” dhe “*interes*”. Këta terma janë më të përdorshëm në fushën e ekonomisë dhe të bankave dhe kryesisht kanë për qëllim: Pjesën e shtuar të cilën ia jep huamarrësi huadhënësit si kompensim për pasurinë qëkahuazuar, në pajtim me kushte të caktuara. Sasinë e shtuar të kapitalit të cilin e fiton si kompensim depozituesi në bankë apo në arkat e kursimeve. Edhe pse gjatë kontratave bankare apo lidhjeve tregtare bashkëkohore bëhet dallim mes kamatës dhe interesit, në aspektin e dispozitave përkatëse rreth këtyre transaksioneve në jurisprudencën islame nuk ka dallim. Në Islam nuk ka dallim mes dispozitës dhe kamatën, fajdesë apo interesit, por të gjitha janë të ndaluara (haram), qofshin këto transaksione akte të shitblerjeve apo kontrata të huamarrjeve dhe kredive (borxheve).

## 2. LASHTËSIA E KAMATËS

Koncepti i kamatës ka një histori mjaft të lashtë; e veçanta e saj është se shkrimet e para vërtetojnë se ajo konsiderohej e urryer dhe e keqe. Ndoshta citati më i vjetër i shkruar për ndalimin e kamatës dhe trajtimit të saj si vepër të shëmtuar është ajo e kohës së faraonëve; legjislacioni i faraonit Buhures nga familja e njëzet e katërt e faraonëve.

Trajtimi i kamatës si gjë e keqe përcillet edhe nga shumë filozofë të vjetër. Vërtetohet se teoricieni dhe oratori i shquar romak Marcus Tullius Cicero e kishte ndaluar kamatën në shkrimet e tij. Gjithashtu edhe filozofët e vjetër grekë, si Platoni te libri “*Republika*” dhe Aristoteli te “*Politika*”, e ndalojnë marrjen e kamatës.

### a. Kamata në fenë hebraike

Kamata ishte e ndaluar dhe e papranueshme edhe në fenë hebraike, sikundërse edhe në atë të krishterë. Kjo vërtetohet në librat e mëhershëm të shpallur, si në Tëvrat (Dhiata e Vjetër) dhe në Ingjil (Dhiata e Re). Por çifutët (hebrenjtë), pas të Dërguarit Musa (a.s) e lejuan marrjen e kamatës nga joçifutët, duke pretenduar se pasuria e joçifutëve është e lejuar për ta. Dihet se besimi hebre është i ndërtuar në parimin se populli hebre është populli i zgjedhur, prandaj ata kanë përparësi dhe vlerë mbi të gjithë popujt e tjerë. Kështu që njerëzit e tjerë, johebrej, ata i trajtojnë si më të ulët, pa vlerë dhe kanë të drejtë t’i manipulojnë si të duan.

Allahu i Lartësuar në Kur’an përcjell pretendimin e tyre: “*Ata (Ehlu Kitabi, pasuesit e librit) thoshin: “Ne nuk kemi kurrfarë përgjegjësie ndaj (pasurisë që u marrim) të paditurve (të tjerëve).”* (Ali Imran : 75)

Ajeti tregon se si çifutët i trajtonin të tjerët që nuk ishin si ata (pra, i quanin të paditur). Edhe çifutët që jetonin në Medinë gjatë kohës së Muhamedit (a.s), njiheshin për intriga dhe keqpërdorime të ndryshme duke u bazuar në këtë parim. Vërtetohet se ata me këtë pretendim ia lejonin vetes manipulimin e çfarëdo forme për të marrë pasuritë e të tjerëve që nuk ishin çifutë në Medinë.

Nëse shfletojmë “*Dhjatën e Vjetër*”, në të hasim tekst ku thuhet: “*Nëse huazon pasuri njërit nga bijtë e popullit tënd, mos u poziciono në pozitë të borxhdhënësit; mos kërkto fitim për pasurin tënde.*” Në një vend tjetër thuhet: “*Nëse varrfërohet vëllai yt, ndihmoje dhe mos kërkto prej tij fitim e as dobi.*” ( Vargu: (25) nga kreu (22) seferul huruxh)

Njerëzit që nuk janë hebrej i trajtojnë si më të ulët, më të pavlerë dhe ata kanë të drejtë të manipulojnë me ta si të duan: “*Për të huajin që të huazon para jepi me interes, por vëllait tënd mos i jep hua me interes.*”

Një murg hebrej do të deklaroi: “Kur ndonjë i krishterë ka nevojë për para, çifuti duhet shfrytëzuar atë nga çdo aspekt. Kamatën e shumëfishitë duhet t’ia shtonë me shumëfish, kështu që ta pamundësoj nga shpëtim deri sa të xh’veshet nga e tëra. Në këtë rast çifuti duke u ndihmuar nga pushteti dhe me ndihmën vendimeve ia konfiskon tërë pronën.” (Eshkar, 2013 : 31)

Në kohën bashkëkohore vërehet edhe më qartë dominimi që ata kanë arritur me intriga të tilla, derisa janë ngritur mbi shtetet më të fuqishme të botës. Mësimet çifute rreth superioritetit të popullit të tyre ndaj të tjerëve dhe trajtimi i të gjitha nacionaliteteve të tjera si në shërbim të tyre nuk është një shpifje apo reflektim i urrejtjes ndaj tyre, por është një realitet që mbështetet në citatet e shumta në Talmudin e tyre.

### b. Kamata në fenë e krishterë

Edhe në Krishterim kamata trajtohet si e ndaluar dhe e urryer. Në Dhiatën e Re kemi disa citate që vërtetojnë ndalimin e kamatës. Gjithashtu ndalimin e kamatës e vërtetojnë shumë njerëz të Krishterimit, sikurse Toma Akuini (1225-1274), Martin Luteri (themeluesi i protestantizmit) dhe shumë të tjerë, saqë Skopari i krishterë thekson:

*“Kush thotë se kamata nuk është mëkat, llogaritet dezertor dhe ka dalë prej fesë”*, që do të thotë se ka dalë prej fesë së krishterë.

Bota e krishterë ka vazhduar për një kohë të gjatë t’i urrejë dhe t’i diskreditojë çifutët për marrjen e kamatës. Këtë e vërteton edhe shfaqja teatrale e Uilliam Shekspirin *“The Merchant of Venice”*, *“Tregtari i Vendikut”*, të cilën e ka shkruar rreth viteve 1596-1598. Në këtë shfaqje bëhet fjalë për një çifut fajdexhi që quhet Shylock. Karakteri i këtij personazhi çifut është mjaft diskreditues, pasi paraqitet nënçmues dhe neveritës ndaj borxhliut nevojtar, të cilit i jep hua me kamatë. Shekspiri me anë të këtij personazhi i paraqet çifutët dhe natyrën e tyre si të dhënë pas lakmisë dhe grumbullimit të pasurisë. Hebrenjtë, që nga koha e daljes së kësaj shfaqjeje, kanë pasur ankth dhe kanë zhvilluar betejë kundër saj. Madje e akuzojnë Uilliam Shekspirin si antisemit<sup>7</sup> dhe po të mos ishte vlera artistike e kësaj veprë dhe e shkruarit të saj, do të zhdukej fare nga arkeologjia kulturore-letrare. Kjo vepër e Shekspirin është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe nga Skënder Laurasi dhe është botuar nga shtëpia botuese *“Mësonjëtorja e parë”* në vitin 2000.

Legjislacionet e vendeve evropiane kanë vazhduar ta trajtojnë kamatën si të ndaluar deri në kohën e revolucionit francez të vitit 1789. Pas kësaj është lejuar kamata në borxhe me disa kufizime. Ky lejim është transformuar edhe në kodifikimet ligjore të Napoleonit, të cilat janë nxjerrë në vitin 1804.

Pas vitit 1808, Franca përcaktoi sasinë e kamatës 5-7% e cila lejohet të merret gjatë transaksioneve tregtare dhe punëve të tjera. Në Francë, në gusht të vitit 1935 doli një ligj që përcaktoi se kush përfiton nga kamata jashtë shumave të kufizuara, llogaritet se ka shkelur Kodin Penal. Ndërsa në legjislaturën italiane, neni 644 i Kodit Penal pohon se ai që punon me kamatë jashtë shumës së përcaktuar llogaritet se ka shkelur Ligjin Penal.

Edhe në ditët tona shohim se ndërjegjja njerëzore nuk ka arritur të çlirohet nga urrejtja e kamatës dhe konsiderimi i saj si krim, mëkat, vepër e pamoralshme, qoftë edhe nëse prej disave lejohet me disa përkufizime dhe përqindje të caktuara që kanë vënë në transaksionet e ndryshme.

#### **c. Kanuni i Lek Dukagjinit**

Ndonëse dihet se burimet e mirëfillta të kanunit të Lek Dukagjinit janë nga feja e krishterë dhe ne sqaruam qëndrimin e saktë të Krishterimit të hershëm rreth kësaj, vlen të ceket se edhe në këtë libër kamata është e ndaluar dhe nuk lejon që njerëzit në mes vete të huazojnë para me kamatë. Në të thuhet: *“Kanūja njeftuhij të fjeshtë: si të dhaëë kë më dhënë.”*, d.t.th. ashtu si të ka dhënë (huadhënësi) ashtu duhet t’ia kthesh. Pra, Kanuni nuk e pranon kamatën; nëse dikush huazon diçka, aq ka për të kthyer, s’ka huazime me interes. Ata që e njohin mirë këtë tekst dhe ligjet që përmban ky libër e kanë të qartë qëndrimin që ka ndaj kamatës.

#### **d. Pikëpamja e filozofëve**

Nuk ishin vetëm fetë që njëzëri ranë dakord për ndalimin e kamatës. Ka shumë mendimtarë jomuslimanë që mbështetën fetë në pikëpamjen e tyre për kamatë. Aristoteli, një nga filozofët grekë midis shekujve të katërt dhe të pestë para Krishtit, denoncon huadhënien e paratë me kamatë duke thënë: *“Paraja është e dobishme për shkëmbim, por kur i tundon njerëzit të grumbullojnë fitime që nuk i përdorin, ose të grumbullojnë pasuri duke dhënë hua, atëherë, paraja bëhet vlerë joproduktive dhe ndihmon në krijimin e pabarazive në pasuri dhe manifestime të tjera të anomalive financiare.”* (Turki, 2020 : 136)

Aristoteli, filozof grek midis shekujve IV-V (p.e.s), dënon ashpër kreditimin e të hollave me kamat. Në veprën e tij *“Politika”*, studimin e tij e ka filluar me kamatën, për të shqyrtuar aspektet e jetës, ku parat i krahason me pulat sterile që vendosen për të fekunduar pa vezë, monedha nuk mund të pjell monedh tjetër.

Platoni në librin e tij ( Shteti dhe Ligjet), shpalos qëndrimin e tij urrejtës ndaj kamatës. Në të ai thotë: *“Nuk është e lejueshme për askënd që të japë me interes.”*

Filozofi në fjalë kamatën e ka konsideruar, në çfarëdo shume qoftë, fitim jo normal, sepse nuk mban që të hollat të jenë produkt rendimenti në vete, pa u përfshirë pronari i saj në ndonjë veprim ose të marrë përsipër ndonjë përgjegjësi. Mendimi i tij është se *“paraja është sterile”*, dhe se paraja nuk lind para, kështu që paraja nuk është vetëm se simbol i shkëmbimit. (Jemanij, 2014 : 152)

Filozofi Ciceron ishte kritikues i ashpër i kamatës. Marrëveshjet me kamatë i ndalonte përfundimisht. Sipas bindjes së tij, krimi i kamatës është i barabart me krimin e vrasjes. Kurse Senika lejonte disa forma të kamatës brenda kufijve, nën presionin e nevojave praktike që kanë dalë në pah me zgjerimin e perandorisë dhe zhvillimin e lëvizjeve të veprimtarisë së tregtisë dhe të kapitalit në provincat e saj. (Vehbe, 2018 : 16)

#### **e. Kamata tek arabët në kohën e injorancës**

Në gadishullin arabik nuk mbeti diç nga trashëgimia fetare që e la gjyshi i tyre Ibrahim (a.s), babai i profetëve, përpos se disa gjurmë të pakë, edhe ata nuk arritën të shmangen ndryshimeve. Tendencat materiale vërehej si në veprimet ashtu dhe në adhurimet e tyre, ndër të cilat bënte pjesë edhe bashkëpunime me kamatë pa kurrfarë kufizimi, qoftë nga tradita apo legjislacioni. Ndoshta kjo kishte të bëjë me dy arsye:

- a) *Tendencat e grumbullimit të pasurisë dhe elani për të fituar*; e cila si zakonisht shtohet në ambiente të cilat lulëzon biznesi, siç është gjendja me Mekën.

b) *Kontakti i vazhdueshëm me të çifutët*, të cilët ishin fqinjë të parë dhe djem të xhaxhallarëve të tyre.

Arabët edhe pse e përdornin kamatën, atë e shihnin me përbuzje. Jo më pakë se që kur muret e Qabes u demoluan dhe Kurejshët kërkonin që të restaurojnë atë, ishin të prirur që të mos mbledhin fondet e nevojshme për shtëpinë e shenjtë nga ata që merren me kamatë, kështu që nuk do të hyjnë në ndërtimin e shtëpisë paraja që është e ndaluar. Ebu Vahb bin Abid bin Umran bin Mahzum tha: *“O Kurejsh! Nuk hyjnë në ndërtimin e saj përpos se para të mira. Nuk hyjnë në të parat e mehrit të padrejtë, shitja me kamat dhe as pasuria e marr nga populli në mënyrë të padrejtë.”* (Ibn Kether, 2017 : 301)

Mënyrën e aplikimit të kamatës në kohën e injorancës do të na i përshkruaj edhe komentatori Xherir et-Taberi, i cili thotë: *“Në kohën e injorancës kur dikush i kishte dikujt hua i thoshte: ju afroju kaq e kaq që të më prolongosh, e ai ia shtinte afatin.”* (Taberi, 2009 : 59)

### 3. QËNDRIMI ISLAM NDAJ KAMATËS

Myslimanët janë unik se kamata është e ndaluar me të gjitha llojet e tij, qoftë pakë apo shumë me përjashtim të detyrimit i cili varet nga ndjenja e individit për përgjegjësinë që do të mbaj para Krijuesit të tij.

Sipas mësimëve Islame kamata llogaritet një nga shtatë mëkatet e mëdha shkatërruese, së bashku me shirkun (të përshkruarit Zotit oponent), magjinë dhe të tjerat. Nëse njeriu e mohon ndalimin e kamatës, me këtë sjellje të tij ka injoruar një nga ndalesat e Zotit dhe konsiderohet mohues.

Kjo dispozitë mbështetet në të gjitha burimet kryesore të legjislaturës Islame: Kur’ani, Sunneti, konsensusi dhe analogji.

Allahu Fuqiptotë dhe i Dërguari i Tij mallkojnë atë që bashkëpunon me kamat, duke u tërhek vërejtjen me shkatëim në këtë dhe në botën e ardhshme: *“E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk heqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me Allahun dhe të dërguarin e Tij”* (El Bekare : 178)

Transmeton Xhabiri (r.a) se i Dërguari i Allahut ka mallkuar atë që e ha kamatën, atë që ushqen kamatën (e jep atë), atë që e evidencon atë si dhe ata që janë në cilësinë e dëshmitarëve në kontratën ku ekziston kamata.” Dhe tha: *“Të gjithë këta janë të barabartë.”* (Shënon Buhariu dhe Muslimi).

Hadithi në fjalë na tregon më së miri se, ai që merr ose jep me kamat do të jetë i fyer, i përbuzur dhe i nënçmuar nga Allahu Fuqiptotë në këtë botë, ndërsa dënimi i tij në botën tjetër do të jetë i dhembshëm.

Kamata gjithashtu është e ndaluar edhe me konsensusin (ixhmanë) e dijetarëve islamë pa kurrfarë hezitimi.

### 4. PASOJAT E KAMATËS

#### *Pasojat politike*

Fatkeqësia e cila mbizotëron në kohën moderne nuk ka qenë me këtë imazh të shëmtuar as në kohën e injorancës. Atë botë, fajdexhinjët imazhin e tyre e prezantonin përmes individëve apo arkës shtetërore, siç prezantohen sot në formë të themeluesve të bankave bashkëkohore. Ndërkaq, në këtë kohë fajdexhinjët përmes forcës, organeve të shtetit, mjetet informative, mediat, mjetet elektronike, veprave të botuara, etj, në masë kanë krijuar imazh pozitiv, duke shkrytëzuar nevojtarët nën hijen e sistemit të kamatës. (Mevdudi, 1987 : 41)

#### *Pasojat shoqërore*

Nëse shikojmë në aspektin social do t’i shohim ndikimet negative të kamatës në shoqëri. Pothuajse nuk ka dy persona e të mos pajtohen se një shoqëri që i trajton anëtarët e saj me interes dhe nuk e ndihmon tjetrin pos se të kërkoj interes (fajde). Ngushtia, varfëria është mundësia e tij për të përfituar dhe investuar, ku interesat e shtresës së pasur janë në kundërshtim me interesat e njerëzve të braktisur. Kjo shoqëri kurrë nuk mund të ngritet dhe të qëndroj në këmbët e saj mbi parime të shëndosha. Ndërkaq, shoqëria që është ngritur në bashkëpunim, ndihmë, solidaritet, anëtarët e saj në mes veti trajtohen me bujari dhe zemërgjerësi. Kur ndonjëri kupton se vëllai i tij është në vështirësi dhe ka nevojë për ndihmë, shtrin dorën e ndihmesës. (Gavuçi, 2018 : 47)

Kur të pasurit vullnetarisht u afrojnë subvencione të varfërve, është e natyrshme që të kultivohet ndjenja e dashurisë së ndërsjellë në zemrat e anëtarëve të kësaj shoqërie. Pjesët e saj janë të lidhura fortë mes veti dhe nuk ekzistojnë arsye të përplasjes së interesave të brendshme, kjo pjesë e shoqërisë më shpejt arrinë ngritje, zhvillim dhe prosperitet.

#### *Pasojat ekonomike*

Efektet negative të kamatës në aspektin ekonomik janë shumë të mëdha. Është epidemi nga e cila nuk ka arritë të shpëtoj dot asnjë pjesë e botës, sepse nuk përkujdeset asnjë qeveri në krijimin e kushteve dhe fondeve nga të cilat nevojtarët do të merrnin hua më lehtë gjatë fatkeqësive dhe rasteve emergjente. Ndërkaq, e dimë mirë se bankat nuk veprojnë vetëm se me transaksione me hua me kthim të larta kredie.

Sikur dyert e bankave të ishin hapura për të varfërit dhe nevojtarët, ku do tu mundësoheshte njerëzve me standard ekonomik të ulët që të drejtohet në bankë për të marr kredi për të realizuar nevojat e duhura, një veprim të tillë do ta

mirëpritnin. Në munges të një situatë të tillë, janë të detyruar që të marrin hua me kredi në raste emergjente prej fajdexhinjëve të cilët i monitorojnë si shqiponjat, që t'i fusin nën kthetrat e tyre. (Kutbi, 2016 : 29)  
Të gjithë ata që kanë nënshkruar një herë kontrat me kredi, vështirë se të shpëtojnë prej saj gjatë tërë jetës. Madje, ka raste ku fëmijët dhe nipërit trashëgojnë mbi supet e tyre kamat nga prindërit dhe gjyshërit e tyre dhe e kanë të vështirë të shpëtojnë prej kësaj bare pëpos se pas shpagimit të kamatës e cila është shumë më e lartë sesa huaja e marr.

## 5. PËRFUNDIM

Gjatë tërë historisë së njerëzimit kamata ka qenë e ndaluar dhe e mallkuar. Nuk ekziston religjion që do ta lejonte një dikuri të tillë negative siç është kamata.

Filozofët e mëdhej siç Platoni, Aristoteli si dhe ligjshënës, nuk kanë qëndruar duar kryqë, suke e quajtur me llojloj etiketime, si urryer, sterile me qëllim për ta ndaluar një herë e përgjithëmon këtë sëmundje kancerogjene.

Shumë ekonomist botërorë do të bëjnë ftesë për eliminimin e kamatës e cila është shkaktare e inflacionit dhe recesionit, dhe se nuk ka alternativ tjetër përpos se ajo të kthehet në zero.

Kamata e tëra është e keqe, çekuilibër dhe luftë për njerëzimin, pasojat e saj janë të shumta, si në aspekt social, etik, politik, ekonomike, etj.

Kontraktimi i përfitimit joproportional, apo fenomeni i “dhënies së parave me fajde”, është gjithnjë e më i shprehur edhe në trojet tona shqiptare. Ky biznes ilegal fitimprurës ka shtrirje të gjerë, ndërkohë sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, në grupacione të tilla janë të përfshirë edhe figura të njohura publike, ndërsa huamarrësit janë më tepër pronarë biznesesh të vogla, që kanë borxhe të mëdha, borxhe që duhen kthyer në afate të shkurtra, apo edhe persona të cilët humbasin sasi të mëdha parash, në lojëra të fatit.

## BIBLIOGRAFI

- Deraz, M.A. (n.d.). “*Err-rriba Fi Nedheril Kanunel- Islami*”.
- Eshkar, O. (2015). *Er-Riba ve etheruhu alel muxhemië el-Islamij*, Dar en nefais, Oman, Jordan.
- Gavuçi, V. (2018). *Mekalat fi riba vel faidetu el mësrifije*, bot. Dar Ibn Hazm, Bejrut.
- Ibadij, M. (2019). *Miser min Aksandr el ekber ila fet'h el arabi*, bot. Mektebe El enxhlu el misrij, Kajro.
- Ibn Kethir (2017). *Tefsir el Kur'an el adhim*, Dar el Ma'rife, Bejrut.
- Ibrahim, I. A. (2014). *Er Riba ve deuru fi istiglal mevarid esh sha'b*, Dar el I'tisam, Kajro.
- Jemenij, T. (2017). *En nidham el Iktisadij fil Islam*.
- Kardavi, J. (2015). *Fevaidi el bunuk*, El Mektebe el Islamij, Kajro.
- Kutbi, S. (2016). *Tefsir ajat er riba*, Dar sh shuruk, Kajro.
- Mevdudi, E.A'la, (2005). *Er Riba*, bot. Dar es Saudije.
- Sokic, D., temën: “*Uvod u Finansijsko Trzhishte*”, fakulteti ekonomik, Beograd.
- Sheukani, M. A. (2016). *Fet'hul Kadir*, Dar Ibn Kethir, Bejrut.
- Taberi, J.(2009). *Xhamiul bejan fi t'vilil Kur'an*, bot. Muesis er- Risale. Kajro.
- Turki, M. I. (2020). *El- Iktisid el islamij bejne en nedherije vet-tetbik*, bot. El mektebe el misrije, Aleksadri.
- Vehbe, M. A.(2013). *Nedherijat el faide (er irba) fif fikr el iktisad*, Bejrut.
- Zuhejli, V. (2016). *El Muamelatel Malijel Muasire*, botim: dare el fikër, Bejrut.